



Censi i bujqësisë shtyhet për në 2026-ën
- Shkak, zgjedhjet.
Nis puna për ngritjen e platformës elektronike

Faqe 2



Rama në Divjakë: Me futjen në BE marrim 300 milionë euro në vit për bujqësinë

Faqe 4



KASH dhe bizneset shqiptare kërkojnë taksë të sheshtë
- Kërkesat për partitë politike. Nga taksa e pronës, tek TVSH-ja e turizmi

Faqe 2



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i parë i muajit mars 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 505
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

SUBVENCIONET 2025 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

SKEMA KOMBËTARE 2025: 44 MILION EURO NË MBËSHTETJE TË FERMERËVE - KRITERET, RISITË DHE SEKTORËT ME NEVOJAT MË TË MËDHA PËR FINANCIM

Në Skemën Kombëtare 2024, janë regjistruar 67,133 përfitues, nga të cilët 52,195 përfituan mbështetje me naftë për punimet mekanizuar në bujqësi. Ndërkohë, nga Skema Kombëtare e Investimeve, deri më tani janë shpallur 163 aplikime të kualifikuara

GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME | **ALBANIA**

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



PORTRET



- Promovohet botimi më i ri Shefqet Mekos - Romani "Rënia" portretizon rrënimin e shoqërisë në vitet '90

Faqe 10

TEMA TË DITËS

- Tjetër vatër me gripin e shpendëve në Durrës, Ministria e Bujqësisë: Mbi 1800 pula të ngordhura Fq.2
- Dita e Verës nxit tregtinë vendase - Zejtari: Kjo ditë shërben për të reklamuar produktet tona Fq.6
- Eliminimi i tregtisë së paligjshme të prod. të duhanit, Malaj në takimin e nivelit të lartë në Mal të Zi Fq.6
- Bujqësia dhe agroturizmi, Rama: Dy linja financimi, nxitje agropërpunimit Fq.7
- Si duhet të përmirësohet digjitalizimi në turizëm? - Sitet kulturore të Shqipërisë në... Fq.7

UNIDO

Analiza e zinxhirit të vlerës dhe kërkesat për eksport të Bimëve Aromatike dhe Mjekësore në Shqipëri

Qeveria Zvicerane mbështet sektorin bujqësor nëpërmjet ndërhyrjeve të Programit Global Për Cilësi dhe Standarde që zbatohet nga UNIDO duke synuar të rrisë në mënyrë të qëndrueshme akses në tregje kombëtare dhe ndërkombëtare për SME-të në zinxhirët e vlerave BAM dhe F&V duke forcuar cilësinë dhe kapacitetin e përputhshmërisë me standardet

Faqe 5

"Paketa e maleve", Mazniku: Shpërndarje e turizmit në territor, nga bregdeti në zonat malore



Faqe 4

POLITIKA MBËSHTETËSE

Braçe: Do vazhdoj betejën për TVSH-në e bujqësisë



Faqe 6

TEMA TË DITËS

Denaj: 1909 teste të akredituara në laboratorët e sigurisë ushqimore, nga 6 në 2013-n

Në Ditën Botërore të Konsumatorit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural riafirmon angazhimin e saj dhe të institucioneve të varësisë për të garantuar produkte cilësore dhe të sigurta për çdo familje shqiptare.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj tha se, “me përparimet në sigurinë ushqimore dhe mbështetjen për prodhimin vendas, sigurojmë që konsumatorët të kenë zgjedhje të besueshme dhe të standardezuara”.

Denaj bëri të ditur se, 1909 teste të akredituara në ISUV, shënojnë një rritje të ndjeshme krahasuar me vetëm 6 teste në vitin 2013 dhe 171 teste më shumë se objektivi për 2024, falë investimeve në teknologji dhe standardeve të BE-së për biosigurinë.

Gjithashtu u shpreh ajo, 52 milionë fara dhe fidanë të certifikuar në 2024 nga ESHFF, ofrojnë lëndë të parë të sigurt

për fermerët tanë, teksa vuri në dukje se, 400 testime për cilësinë e materialit mbjellës dhe 88 testime për varietete të

“Garantojmë cilësi dhe siguri ushqimore për të mbështetur prodhimin vendas dhe për të rritur besimin e konsumatorëve, ndërsa avancojmë në



reja në Katalogun Kombëtar, janë hapa konkretë drejt rritjes së cilësisë dhe eksporteve.

Ministrja shprehu angazhimin për garantimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

torëve, ndërsa avancojmë në përafrimin e Kapitullit 12 me standardet e legjislacionit evropian, në rrugën drejt Shqipërisë 2030 në Bashkimin Europian”, tha Denaj.

Censi i bujqësisë shtyhet për në 2026-ën - Shkak, zgjedhjet. Nis puna për ngritjen e platformës elektronike

Censi i Bujqësisë, i cili përfshin numërimin e fermave dhe të bagëtive në të gjithë vendin do të shtyhet për në vitin 2026.

Edhe pse ishte planifikuar të kryhej këtë vit, pas Censit të popullsisë dhe banesave, arsyeja e shtyrjes lidhet me zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të cilat mbahen më 11 Maj 2025.

INSTAT ka nisur fazën përgatitore për implementimin e Censit të Bujqësisë, i cili do të luajë rol vendimtar në përditësimin e informa-

të grumbullimit të të dhënave, ndërsa anketimi në terren do të bëhet vitin e ardhshëm.

Një modul pyetjesh, u përfshirë në pyetësorin e Censit të Popullsisë dhe Banesave, me qëllim krijimin e listës së fermave bujqësore, e cila do të shërbejë si bazë zgjedhje për censin e ardhshëm të bujqësisë, kjo për arsye të mungesës së regjistrimit administrativ të fermave.

Anketues të trajnuar do të vizitojnë njësitë ekonomike bujqësore në mbarë vendin, për të mbledhur të dhëna ba-

veçanta, në të gjitha fermat bujqësore që kanë të bëjnë me: ujitjen, praktikën e menaxhimit të tokës, makineritë dhe pajisjet dhe pemëtarinë, të cilat rrjedhin nga zbatimi i rregulloreve të Komisionit Evropian mbi Vrojtimit Strukturore të Fermave, me vit reference vitin 2023, për vendet anëtare të BE.

Censi i Bujqësisë do të sigurojë gjithashtu të dhëna për strukturën e bujqësisë, veçanërisht për njësitë e vogla administrative.

Baza materiale për kryerjen e këtij procesi është ajo e përdorur për Censin e Banesave 2023, ndërsa ende nuk është llogaritur një kosto totale.

INSTAT do të bashkëpunojë edhe me institucione të tjera, veçanërisht me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për krijimin e një kornize/liste të besueshme dhe të përditësuar për t'u përdorur për mbledhjen e të dhënave në terren.

Një strategji e dedikuar komunikimi do të zhvillohet dhe finalizohet për Censin e Bujqësisë, e cila synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të nxjerrë në pah rëndësinë e Censit të Bujqësisë në audiencën e synuar.

Ky proces fillimisht ishte parashikuar të kryhej gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2024.



cionit statistikor të nevojshëm në nivel lokal dhe rajonal dhe pasqyrimin e ndryshimeve në që kanë ndodhur në këtë sektor në më shumë se një dekadë.

Aktualisht po punohet për ngritjen dhe vënien në funksion të platformës elektronike

zuar në pyetësorin e Cens. Do të ndiqen procedura të standardezuara për të ruajtur konfidencialitetin dhe saktësinë gjatë gjithë procesit të mbledhjes së të dhënave. Censi i Bujqësisë do të sigurojë informacione mbi module të

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar dhe bizneset shqiptare kërkojnë taksë të sheshtë - Kërkesat për partitë politike. Nga taksa e pronës, tek TVSH-ja e turizmi

Bizneset shqiptare kërkojnë implementimin e një sistemi të ri fiskal i cili ka si bazë rikthimin e taksës së sheshtë. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, në bashkëpunim me një sërë shoqatash biznesi, ka bërë disa propozime konkrete fiskale për forcat politike në vend, me qëllim përfshirjen e tyre në programet ekonomike.

Nikolin Jaka, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë:

“Aplikimi i një sistemi të ri fiskal me një taksë të sheshtë 10% për të nxitur investimet, rritjen e pagave dhe formalizimin e ekonomisë. Kjo do të krijojë më shumë vende pune dhe do të lehtësojë barrën mbi bizneset dhe qytetarët Norma e TVSH-së për sektorin e agro-përpunimit të bëhet 5%-7%. Rivendosja e shkallës së kompensimit të fermerëve për TVSH-Kreditim me 75% të TVSH për shitjen e produktit bujqësor vendas nga subjektet që nuk janë objekt i TVSH-së. Përfshirja nga TVSH-ja për investimet, në importin e impianteve dhe pajisjeve për fotovolatike, eolike etj pavarësisht vlerës së investimit”.

Për sektorin e turizmit propozohet vendosja e bakshishit të detyruar dhe subven-

cionet e pagave për punonjësit jashtë sezonit.

“Aplikimi i TIPs (shpërblimi) - Nisur nga eksperiencia e shumë vendeve të botës fatura përmban sektorin "TIP" (bakshish) që i jep mundësi klientit, të shpërblejë personelin e shërbimit pa rënduar xhiron e sub-



jektit. Kjo do të ndihmojë në rritjen e interesit për të punuar në sektorin e shërbimeve. Mendojmë se në Shqipëri duhet të mos taten të ardhura që shkojnë deri 1500 Euro. Subvencionet në paga e sigurime për punonjësit sezonal të turizmit-Turizmi është një industri sezonale. Nuk mund të kesh punonjës të kualifikuar dhe trajnuar me një sezon në bregdet 3-5 muaj dhe ku gati 70% e punonjësve duhet të kalojnë në një punë tjetër për të pasur një sigurancë gjithëvjetor dhe vjetërsi pune”.

Sai takon sektorit të ndërtim-

it, propozohet ulje e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe taksë së kalimit të pronësisë.

“Taksa e ndikimit në infrastrukturë, përveçse duhet të rishikohet në aspektin e shkallës tatimore të aplikuar, në veçanti në Tiranë, ku identifikojmë si më të përshtatshëm

rangun nga 2-6%, mënyra e llogaritjes së saj propozojmë të jetë e orientuar edhe drejtë koston. Të hartohet një ligj për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme në masën 3-5% (3% për ndërtesa rezidenciale dhe 5% për ndërtesa komerciale). Taksa për kalim të pasurisë së patundshme të jetë jo më shumë se 7%”.

Bizneset besojnë se për të ndërtuar një ekonomi të qëndrueshme, është e nevojshme një qasje që mbështet bizneset, krijon mundësi të reja punësimi dhe nxit rritje ekonomike.

Tjetër vatër me gripin e shpendëve në Durrës, Ministria e Bujqësisë: Mbi 1800 pula të ngordhura

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural konfirmoi për një vatër të re të Influcencës Aviare (H5N1), i njohur ndryshe si gripi i shpendëve.

Në njoftimin zyrtar, MBZHR sqaron se, vatra e re është konstatuar në fshatin Maliq Muço në Rrëshbull të Durrësit, ndërsa grupi i veterinerëve ka konstatuar se në fermën në fjalë kanë ngordhur 1848 shpendë, të prekur nga H5N1.

Ministria deklarom se ka ndaluar shitjen dhe tregtimin e shpendëve të gjallë në Sukth, Manëz, Katund i Ri, Maminas, Gjepalaj, Rashbull, Thumanë, Bubq, Prezë dhe Vorë.

Njoftimi i plotë për mediet:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të transparencës me publikun, informon se ditën e sotme është konfirmuar një tjetër rast i pranishëm së sëmundjes së Infl-

encës Aviare me patogjenitet të lartë (H5N1), në një stabiliment mbarështimi dhe prodhimi shpendësh në zonën e mbrotjes së karantinuar (3 km) me vendodhje në fshatin Maliq Muço, Njësia Administrative Rashbull, Bashkia Durrës.

Shërbimi veterinar rajonal së bashku me përfaqësues të MBZHR janë paraqitur menjëherë në subjekt për tu njohur me gjendjen shëndetësore të shpendëve duke konstatuar 1848 shpendë të ngordhur. Strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet përkatëse të varësisë kanë marrë masat në mënyrë të menjëhershme, pas njoftimit për vendosjen e stabilimentit në karantinë, ku janë marrë mostra zyrtare, të cilat janë dërguar dhe analizuar brenda ditës në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Pas konfirmimit nga ISUV për rezultatin pozitiv të analizimit, në MBZHR është thirrur takimi i Qendrës Kombëtare të Krizës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve edhe të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, Ministrisë për Pushtetin Vendor dhe Institutit të Shëndetit Publik.

Janë në fuqi Urdhri i Ministrisë Nr. 200 datë 3.3.2025 dhe Urdhri 240, datë 9.3.2025 “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla”

Njoftojmë fermerët dhe mbarështuesit e cilësdo lloj speciej shpendësh se vijon të jetë e ndaluar lëvizja e shpendëve nga fermat e Njësive Administrative Sukth, Manëz, Katund i Ri, Maminas,

(Vijon në faqen 6)

INTERVISTË

SUBVENCIONET 2025 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

SKEMA KOMBËTARE 2025: 44 MILION EURO NË MBËSHTETJE TË FERMERËVE - KRITERET, RISITË DHE SEKTORËT ME NEVOJAT MË TË MËDHA PËR FINANCIM

Në Skemën Kombëtare 2024, janë regjistruar 67,133 përfitues, nga të cilët 52,195 përfituan mbështetje me naftë për punimet mekanizuara në bujqësi. Ndërkohë, nga Skema Kombëtare e Investimeve, deri më tani janë shpallur 163 aplikime të kualifikuara

Më 6 mars, u miratua V.K.M. për përcaktimin e kriterëve bazë të mbështetjes për Skemën Kombëtare 2025, ku do të subvencionohen fermerët me një fond prej 44 milionë eurosh përmes masave të ndryshme mbështetëse. Edhe këtë vit, ashtu si vitet e kaluara, aplikimet do të kryhen online, përmes aplikacionit E-Albania.

Në Skemën Kombëtare 2024, janë regjistruar 67,133 përfitues, nga të cilët 52,195 përfituan mbështetje me naftë për punimet mekanizuara në bujqësi. Ndërkohë, nga Skema Kombëtare e Investimeve, deri më tani janë shpallur 163 aplikime të kualifikuara.

Edhe këtë vit, përmes Skemës Kombëtare do të ofrohet mbështetje për: tufën bazë të matrikulluar (gjedhë), të imtat, fara, fidanë dhe inpute në serra, mbarështimin e bletarisë, bimët mjekësore-aromatike, fermat organike, certifikimin Global Gap, si dhe mbështetje me naftë për punimet mekanizuara në bujqësi. Risia e këtij viti është subvencionimi për krerë viçash, si dhe subvencionimi shtesë për ata fermerë që përdorin kontrollin biologjik në serra. Nuk ka tavanë financimi për bashkimin e fermerëve, ndërsa fermerët individualë do të përfitojnë deri në 50% të subvencioneve nëse kalojnë kufizimet e financimit.

Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj, në një intervistë për emisionin “Top Talk”, foli mbi shpërndarjen e fondeve të kësaj skeme dhe theksoi sektorët me nevojat më të mëdha për financim.

Intervista e plotë

Z. Rrapaj, është miratuar V.K.M. për Skemën Kombëtare 2025. Prisnit më shumë ndryshime në masat mbështetëse të parashikuara?

Po, prisnim më tepër ndryshime në skemën e këtij viti. Së pari, prisnim një rritje të vlerës së fondit në dispozicion, dhe kjo për shkak të situatës në të cilën ndodhet sektori bujqësor. Shumë fermerë po largohen nga fshati, subjektet po mbyllin aktivitetet e tyre dhe ata që po rikthehen janë më pak se ata që po ikin. Duhet të përpiqemi të ndryshojmë këtë situatë me të gjitha mënyrat dhe një prej mundësive është mbështetja përmes Skemës Kombëtare.

A mbështeten të gjithë sektorët problematikë përmes masave mbështetëse të Skemës Kombëtare 2025?

Nuk mbështeten të gjithë sektorët, pasi kjo është e vështirë të arrihet përmes një skeme të vetme, por e rëndësishme është që sektorët që mbështeten të mos lihen me mangësi, ashtu siç ka ndodhur deri më sot. Këtu i referohem kufizimeve përmes tavanëve të financimit, jo për kriteret minimale të përfitimit, pasi kjo është e lidhur me formalizimin dhe efikasitetin e subjekteve.

Të dhënat statistikore kanë treguar që kemi një rënie të numrit të krerëve në blegtori, krahasuar me të shkuarën por dhe me vendet e rajonit. Këtë vit do të kemi risinë për mbështetje me krerë viçash. A e ndihmon kjo blegtorinë shqiptare?

Sigurisht që kjo mbështetje ndihmon, pasi parandalon rënien e numrit të krerëve në blegtori. Mbështetja për viçat meshkuj ndihmon për përmirësimin e rracës, si dhe prodhimin e mishit, në mënyrë që të kemi mundësinë të furnizojmë konsumatorët me mish cilësor vendas. Njëkohësisht, kjo na mundëson të ruajmë edhe mëshqerrat për rinovimin e tufës. Kjo risi nuk duhet të bëhet vetëm për gjedhët, por edhe për të imtat, në mënyrë që t'i kushtojmë rëndësi rinovimit të tufës. Risia është e vlefshme për përmirësimin e rracës, por gjithashtu edhe për shtimin e numrit të krerëve.

Vitin e kaluar ka pasur një rritje të sasisë së mishit të importuar. Si mund të zgjidhet kjo problematikë?

Skema Kombëtare është një nga instrumentet mbështetës,

por duhet të kemi edhe instrumente të tjera për të stabilizuar dhe ndërprerë rënien e blegtorisë. Duhet të përfshijmë patjetër modele të reja dhe projekte pilot, në mënyrë që të përballojmë situatën. Së dyti, duhet të vazhdojmë të forcojmë rolin e zooteknikut. Pa punën e zooteknikut, ne nuk mund të stabilizojmë dhe të rrisim rendimentin në sektorin e blegtorisë.

Gjithashtu, duhet të shtojmë investimet në kullota, pasi pa to nuk mund të përballojmë të gjitha proceset që kemi sot, duhet të rrisim fondet për mirëmbajtjen e kullotave dhe luftimin e sëmundjeve. Është e domosdoshme që t'i kushtojmë vëmendje të veçantë shërbimit veterinar privat. Pa një bashkëpunim të ngushtë dhe forcim të shërbimit veterinar privat, nuk mund ta përballojmë situatën në sektorin e blegtorisë.



Masat që janë marrë janë dobiprurëse, por janë të pamjaftueshme për të mundur dhe ndaluar këtë rënie të madhe që po merr sektori i blegtorisë. E fundit dhe më e rëndësishmja është grupimi i fermerëve. Ne duhet patjetër të konceptojmë modele grupimi që funksionojnë në vendin tonë. Nuk duhet të mbështemi vetëm të SHBB-të, të cilat nuk na dhanë atë që prisnim, por duhet të mbështesim grupimet e fermerëve, të cilët u mbështetën edhe vitin e kaluar përmes Skemës Kombëtare dhe do të vazhdojnë të mbështeten këtë vit. Grupimi është një element kyç për të përballuar pasojat e Ligjit 7501.

Duke u nisur nga avantazhet që ofrohen për grupimet e fermerëve, a pati një rritje të numrit të aplikimeve në grup vitin e shkuar?

Patjetër që pati një rritje. Nga viti 2021 deri në vitin 2024, kishim vetëm SHBB-të, ndërsa pas nxitjes që u dha vitin e kaluar për grupimet, të cilat do të kualifikoheshin dhe do të vlerësoheshin të parat dhe subvencionoheshin pa tavanë financimi, u krijuan mbi 300 grupime që aplikuan në Skemën Kombëtare.

Tani duhet të fillojmë të krijojmë grupe për njësi shërbimi. Nuk mund të shërbejnë në zonat rurale sot ata që janë mbi 60 vjeç. Ata mund të punojnë për vetëkonsum, por nuk mund t'i shërbejnë tepriçës tjetër të tokës që kanë marrë. Njësitë e shërbimit janë shumë të nevojshme, sipas nevojave të sektorëve të ndryshëm dhe në fund, fitimi të ndahet mes pronarit dhe njësisë së shërbimit.

Njësitë e shërbimit janë të lidhura ngushtë me qendrat e grumbullimit. Ato i shërbenin fermerit me të gjitha aftësitë e tyre, duke asistuar gjatë prodhimit dhe duke marrë në fund produktin, si edhe duke ndarë fitimin. Pas heqjes së TVSH-së, njësitë e shërbimit nuk kishin interes për të vazhduar këtë bashkëpunim. Ne kemi realizuar edhe një sondazh për të vlerësuar këtë bashkëpunim. Ishin 42 mijë fermerë që bashkëpunonin me qendrat e grumbullimit, dhe atëherë nuk kishim aq shumë qendra sa kemi sot. Ne kemi investuar në rritjen e numrit të qendrave të grumbullimit, në mënyrë që ato ta kryenin këtë shërbim dhe shpresojmë që ta vazhdojnë, pasi TVSH-ja të sistemohet.

Kërkohen edhe disa masa të tjera shtesë, për të siguruar që kjo marrëdhënie jetësore midis prodhuesit, grumbulluesit dhe tregtarit të zgjidhë një sërë problemesh që kemi, siç është kostoja e lartë e produktit, prodhimi pa cilësi, mungesa e standardeve, certifikimi, si edhe linjat e ambalazhimit të produkteve. Të gjitha këto probleme mund të zgjidhen nga vetë aktorët e prodhimit, nga ata që kanë marrë mbi vete barrën për të punuar në këtë sektor.

Së fundmi është lancuar programi i kredisë së butë, i ndërthurur me garancinë sovranë, e cila mundëson mbulimin e kolateralit deri në masën 70%. MBZHR ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e përfshirë. Si po shkon ky proces dhe çfarë pritet nga kjo skemë?

Realisht, pritet një lehtësim i situatës në lidhje me financimin në këtë sektor, i cili ka qenë gjithmonë një mangësi. Bankat e nivelit të dytë, që ofrojnë kredi sot me kolateral, nuk e japin pa një normë interesi 7%, ndërsa shoqëritë e mikrofinancës kanë një interes, jo më pak se 16.5%. Në këto kushte, ishte e pamundur të vazhdohej me ritmet që ne duhet të ecim. Interesat e larta, si dhe humbja e rreth 30% të prodhimit gjatë procesit të prodhimit, e bënë të vështirë për fermerët që të mbulojnë këto kosto. Si rezultat, atyre nuk u mbetet asgjë për të zhvilluar aktivitetin e tyre.

Cilat kategori të fermerëve do të trokasin në dyert e bankave për të përfutur nga kjo skemë?

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar i ka grupuar bizneset në tre kategori: Grupi i parë përfshin ata që punojnë për vete, për blegtorinë e tyre dhe nuk kanë tepriçë të produktit. Ky grup përbën një shumicë të madhe të fermerëve dhe kanë pasuri të pashfrytëzuara. Grupi i dytë përfshin ata që punojnë për vete, për blegtorinë e tyre dhe kanë tepriçë të produktit. Ndërsa grupi i tretë përfshin fermerët e stabilizuar, ata që kanë marrë toka me qira, kanë bërë investime dhe kanë kontrata me eksportin. Dy grupet e para përbëjnë 72% të sektorit, ndërsa grupi i tretë përbën 28%.

Krijimi i grupeve të fermerëve është zgjidhja e vetme për të rritur stabilitetin. Përmes këtyre iniciativave mund të rrisim përqindjen e grupit të tretë dhe ta kthejmë në një faktor të favorshëm, pasi nëse mbështetet dhe nxitet, do të jetë lokomotiva e sektorëve të tjerë, ku do të përfshijë fermerë edhe nga dy grupimet e para.

Ne këmbëngulim tek bashkimi, kooperimi, koordinimi dhe mekanizimi, si dhe inovacioni, përmes mbështetjes me financim. Por, nuk duhet harruar nevojat për përmirësime ligjore, të cilat janë të domosdoshme. Kushtet e Bashkimit Evropian kërkojnë që ne të jemi në gjendje të përballojmë konkurrencën, kushtet e vështira të motit, situatën ndërkombëtare të çmimeve dhe situatën në të cilën ndodhemi. Shpesh, ne kujtohem për problemet kur përballemi me to, por nuk kemi një strategji të qartë apo objektiva të përcaktuara. Gjithashtu, është e rëndësishme të përballojmë nevojat e konsumit që vijnë nga zhvillimi i turizmit, duke ofruar ushqime vendase dhe duke reduktuar importet.

Programi IPARD III pritet të fillojë vitin e ardhshëm, me një shumë prej 146 milionë eurosh që do të vendosen në dispozicion të bujqësisë. Çfarë ka ndodhur gjatë këtyre viteve që programi IPARD ka munguar?

Për të përfutur nga programi IPARD II, u paraqitën rreth 1040 kërkesa dhe prej tyre u financuan rreth gjysma e aplikimeve, ndërsa pjesa tjetër u skualifikua për arsye të ndryshme. Shumë projekte u nisën dhe nuk u zhvilluan, dhe kjo çoi në situatën që kemi sot. Me vonesën e hapjes së IPARD III, kemi pësuar një stanjacion në sektorin e bujqësisë. Pa mbështetjen e fondeve të Bashkimit Evropian, është e vështirë të përballojmë situatën. Shpresojmë që fundi i këtij viti të na gjejë me masa të miratuara.

AKTUALITET

Rrugë e re që lidh dy fshatra me Karavastanë, zhvillim ekonomik e turistik, jo zhavorr e elektoral

Transformimi urban është shtrirë në çdo qytet të vendit, duke zgjeruar rrjetin e rrugëve të reja me infrastrukturë të përmirësuar, lehtësisht të aksesueshme për këmbësorë dhe mjete.

Përfituese e investimeve të qeverisë në lagje e rrugë të reja është edhe bashkia Divjakë, ku aktualisht po punohet në kantier për rikualifikimin e rrugës Gurë – Remas, me gjatësi afërsisht 3,2 kilometra, e cila është një segment lidhës midis dy

vetëm.

“Ndodhemi në një nga segmentet që FSHZH po ndërton brenda bashkisë së Divjakës. Është segmenti Remas- Gurë, 3,2 kilometra, segment, i cili kalon në zonë të banuar, por e cila nuk është në zonë e mirëstudiuar, shtëpitë dhe densitetin e kanë të shpërndarë. Këto 3,2 kilometra tashmë kemi mbaruar me gjeotekstilin, është hedhur edhe çakull dhe në disa nga pjesët janë dhe pjesët që ka filluar të

zhvillim të ri në të gjitha drejtimet. Zhvillimi i bujqësisë, të paktën në bashkinë ku unë jam, është i jashtëzakonshëm dhe ndihmesa e qeverisë ka qenë e prekshme, e dukshme, e qartë, e pastër, pa mëdyshje me asnjë interes elektoral”, u shpreh ai.

Nga ana e tij, kryeministri Rama vlerësoi punën e bërë në modernizimin e dukshëm të infrastrukturës, duke hapur rrugët bujqësore të lëvizjes së prodhimit, si dhe rrugët turistike.

“Tani, praktikisht, ne pothuajse i kemi mbyllur të gjitha rrugët ruralet këtu në Divjakë. Kjo është për të gjithë ata që thonë “Fshati, fshati, nuk keni bërë për fshatin”. Se ku do t’i shikoni ju rrugët e fshatit, ku, në kënetën mediatike që nuk ka punë tjetër përveçse “E kapi, hyri, iku, hyri, doli, vodhi, erdhi,”? Nuk i shihni dot rrugët e fshatit aty, nuk kanë lidhje me fshatin fare ata që flasin atje. Nga ana tjetër, nuk është vetëm Divjaka. Janë shumë e shumë zona dhe shumë e shumë territore, ku ka pasur zhvillim të infrastrukturës rurale gjithmonë, jo elektorale, por strategjike, jo hajde e hidh zhavorr e çakull, dy lopata asfalt për të marrë vota, por përditë e përditë, thujse 12 vjet më parë, -jo 12 vjet se nja 2 vjet na u deshën vetëm për të filluar të dalim nga gropa që na kishin zhytur me ato borxhet e tyre të tmerrshme, – por një dekadë me radhë, pak nga pak, hap pas hapi, rrugët bujqësore të lëvizjes së prodhimit, rrugët turistike të hapjes së perspektivave të reja në zona, ku nuk shkohej dot as me traktor e jo më të shkoje me veturë”, u shpreh Kryeministri.



fshatrave Gurë dhe Remas, e gjithashtu lidhet me rrugën e Karavastasë.

Nga pikëpamja urbane rruga bën pjesë në zonat ku objektet e banimit janë të vendosur në formë të çrregullt, densiteti i ndërtimit është i ulët dhe hapësirat publike e trotualet pothuajse mungojnë tërësisht. Gjithashtu nuk ka rrjet kanalizimesh, dhe mungon ndriçimi e sinjalistika vertikale dhe horizontale.

Kryeministri Edi Rama ishte sot në Divjakë, për të inspektuar ecurinë e punimeve në kantier ku zbatimi i projektit të ri, do të bëjë të mundur ndërtimin e një infrastrukture sa më të përshtatshme për banorët e zonës së fshatit Remas dhe jo

shtrohet dhe tapeti në këto momente. Janë pastruar kanalet anësore sepse është një nga problemet më të mëdha në këtë zonë. Nga ana tjetër, e quajmë shumë të rëndësishme këtë rrugë, jo vetëm sepse bashkon dy fshatra, por edhe e bashkon me rrugën e Karavastasë në të gjitha planet tona për zhvillimin e turizmit në këtë zonë” shpjegoi Zv/Kryeministrja dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, e cila shoqëronte Kryeministrin në këtë vizitë.

Ndërsa, Kryetari i bashkisë Divjakë, Josif Gorrea tha se me mbështetjen e ofruar nga qeveria, zona do të marrë një zhvillim të ri. “E gjithë kjo zonë do marrë një

Rama në Divjakë: Me futjen në BE marrim 300 milionë euro në vit për bujqësinë

Kryeministri Rama undal në fermën blegtorale “Vjen”, një nga fermat shembull në Shqipëri e cila falë mbështetjes me fonde e subvencione, ka rritur kapacitetet e saj të prodhimit, duke arritur të prodhojë deri në 19 ton litra qumësht në ditë.

Sëbashku me zëvendëskryeministrin Belinda Balluku, drejtoreshën e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Ardita Kuçi dhe zëvendësministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Dhimitër Kote, panë nga afër të gjithë procesin që kalojnë krerët, që nga ushqyerja e deri tek mjelja.

“Kemi qenë në kapacitete rreth 1050 krerë, sot jemi 1700 krerë, shpresojmë që në vitet e ardhshme të shkojmë në 2000 krerë. Dhe jemi munduar jo të rritemi shumë në numër krerësh po të rritemi aq sa kemi mundësi të prodhojmë ushqim voluminoz me pjesën më të madhe të punës, pra të ushqimit të prodhuar këtu në vend. Prodhimë çdo ditë rreth 19 ton qumësht, e shesim në 4 fabrika këtu në Shqipëri. Po të mos kishte qenë qeveria dhe financimet e Bashkimit Evropian, ne nuk do ta kishim atë që shikojmë tani, duke punuar. Ne ndoshta do ia kishim arritur me forcat tona po për vitin 2027-2028. Ne jemi sot në 2025, kemi 4 vite që importojmë dhe i shikojmë benefitet e tij çdo ditë sepse kemi mundësi që ta menaxhojmë tufën”, – u shpreh njëri nga sipërmarrësit.

Kryeministri vlerësoi punën e bërë në këtë fermë dhe u shpreh se prioritet duhet të ketë bashkimi.

“Që të stimulojmë bashkimin nuk është çështja sipas meje që ta kenë të gjithë kështu. Kush nuk ka mundësi ta ketë kështu, e sjell, e bashkon dhe merr pjesën e vet. Tani sivjet është edhe risia tjetër, se ju jeni tjetër nivel. Risia tjetër është gjithë ajo linja e financimit të Bankës së Shq-

përisë 250 milion euro dhe aty ju mund të aksesoni lirisht sepse jeni biznes i madh. Me atë mbështetja bëhet edhe më e madhe. Plus që duhet të bëjmë patjetër kapërcimin që të hyjmë në Bashkimin Europian sepse direkt na vijnë 300 milion euro në vit vetëm për bujqësinë, 300 milion euro që është e paimagjinueshme. Me kushtin që të bashkojnë

edhe Kroacia, edhe vende të tjera kanë bërë negociim që shiko: sepse faktikisht për të hyrë në BE duhet ti kesh të gjitha standardet dhe ata të thonë janë gati, futi. Por janë çka fusha, element të veçantë që ti nuk i bën dot kaq shpejt do të marrësh kohë. Dhe një nga gjërat po negociojmë është kjo, çështja e si kalon prodhimi në tavolinë dhe ke



forcat, ca do të thotë kjo? Do të thotë që edhe me ndihmën e bashkive, edhe me rritjen e kapaciteteve tuaja të bashkohen. Pra ta thashë, unë kam dy lopë ti sjell këtu, flasim për ata që janë aplikantë, që vijnë kërkojnë. Atyre i duhet dhënë drejtimi: Bashkohuni, kjo është rruga”, – tha Kryeministri.

“Veç mbështetjes që merrnin për 50 krerë, tani marrim mbështetje dhe mbi 50 krerë dhe kemi shtuar skemën dhe mbështetjen për viçat meshkuj”, – u shpreh zëvendësministrin Kote.

Investimet në sipërmarrje të tilla në gjithë vendin, synojnë jo vetëm rritjen e prodhimit, por dhe rritjen e standardeve, duke u përgatitur për tregun e Bashkimit Europian.

“Shiko të të them një gjë unë ty për këtë punë e BE-së. Ne duhet të mbarojmë negociatat deri në fund të 2027. Ne kemi disa çështje që po i negociojmë për të marrë më shumë kohë. E kanë bërë

qumështi, ke therjen të gjëja e gjallë është pika kyçe. Bullgaria ka hequr të zitë e ullirit sepse nuk ia pranonte njeri me therje rrugëve. Edhe ne kemi bërë goxha progres te kjo pikë, po prapë na duhet. Dhe kjo që thotë Dhimo, pa veteriner ku të shkosh, kush të lë. Dhe nuk është çështja vetëm për BE-në, është çështja për shëndetin, është çështja për sigurinë. Këtu çështja nuk është për të mos i dhënë, këtu çështja është për t’i shtuar. Po për ti shtuar që ti shtojnë. Pra ka dy lloj mënyrash për ta dhënë: O jep subvencion si lëmosh sociale dhe ajo nuk sjell asgjë, vetëm riciklon mbijetesën, ose jep një subvencion që jep diçka dhe ajo rritet. Ne kemi kohë që e kemi ndryshuar linjën dhe hap pas hapi po kalojmë te zhvillimi, por ne nuk jemi aq të pasur sa t’i bëjmë të dyja. Ne duhet të bëjmë një zgjedhje, dhe kjo është zgjedhja që kemi bërë dhe po funksion”, – nënvizoi Kryeministri Rama.

Ministri i Shtetit për Pushetetin Vendor, Arbjan Mazniku u shpreh se, priligji për “Paketën e maleve”, zgjidh një problem shumë të rëndësishëm në raport me zhvillimin e turizmit në Shqipëri.

Duke marrë fjalën në seancën e Kuvendit, Mazniku tha se turizmi në vendin tonë është motori kryesor i zhvillimit ekonomik.

Ai solli në vëmendje se, në 2013 Shqipëria numëronte 1 milion turistë ndërsa vitin e fundit janë 12 milionë turistë që kanë vizituar vendin tonë.

Mazniku u shpreh se të ardhurat nga turizmi janë rritur ndjeshëm.

“Në vitin e fundit turistët kanë shpenzuar në Shqipëri

“Paketa e maleve”, Mazniku: Shpërndarje e turizmit në territor, nga bregdeti në zonat malore

rreth 5 miliardë euro, ose 17% të PBB dhe nga kjo shumë 1.7 miliardë euro ose 35% kanë shkuar në hoteleri; 1,5 miliardë euro të ardhurave nga turizmi kanë shkuar për restorantet, ku kanë përfituar kamarierët stafet e restoranteve, pagat e të cilëve janë rritur. Ndërsa 1 miliardë ose 20% e parave të turistëve që kanë shpenzuar në Shqipëri kanë shkuar për bujqësinë dhe 750 milionë të tjera në transport”, theksoi ministri.

Sipas tij, këto të ardhura



kanë qenë të shpërndara në çdo sektor, por nuk ka një balancë shpërndarje të tillë nga ana gjeografike.

“P.sh vijoi ai, Himara i ka pasur të ardhurat e veta për frymë 71 mijë lekë për banor, më të larta se Tirana dhe Vlora. Ndërsa bashkitë si Mati i ka pasur 5 mijë lekë të ardhurat për frymë apo Fushë-Arrëzi 4 mijë lekë për frymë, 5 herë më pak se Himara. Puka 4 mijë lekë për frymë 6 herë më pak Himara”.

Mazniku shpjegoi se, zhvillimi

i turizmit ka treguar përmirësim ekonomik të bashkive, teksa theksoi se, “fokusi ynë është shpërndarja e turizmit në territor, jo vetëm në zonat bregdetare por edhe ato malore”.

Ai tha se, me këtë nismë i japim zgjidhje problemit të pronës, aplikimit për një leje zhvillimore në turizëm dhe mundësi poseduesve të mirëfilltë të tokës për ta zhvilluar pronën e tyre në funksion të turizmit që rrit të ardhurat ekonomike.

Në këtë kontekst, tha ai, kjo nismë i përgjigjet edhe dëshirës së emigrantëve që duan të investojnë në tokat e tyre dhe të kenë mundësinë të zhvillojnë turizmin në zonat malore të vendit.

KËRKESAT PËR EKSPORT NË VENDET E BASHKIMIT EVROPIAN

ANALIZA E ZINXHIRIT TË VLERËS DHE KËRKESAT PËR EKSPORT TË BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE NË SHQIPËRI

Qeveria Zvicerane mbështet sektorin bujqësor nëpërmjet ndërhyrjeve të Programit Global Për Cilësi dhe Standarde që zbatohet nga UNIDO duke synuar të rrisë në mënyrë të qëndrueshme akses në tregje kombëtare dhe ndërkombëtare për SME-të në zinxhirët e vlerave BAM dhe F&V duke forcuar cilësinë dhe kapacitetin e përputhshmërisë me standardet

Ky artikull është pjesë e një raporti që detajon rezultatet e vlerësimit të zinxhirit të vlerës për bimët mjekësore dhe aromatike (BAM). Ky vlerësim u krye në kuadër të projektit “Analiza e zinxhirit të vlerës së bimëve, frutave dhe perimeve aromatike dhe mjekësore në Shqipëri”, e mandatuar nga UNIDO si pjesë e Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) dhe financiar nga Qeveria Zvicerane. Një raport përkatës është përgatitur për sektorin e pemëve dhe perimeve (F&V).

Qeveria Zvicerane dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO) në Shqipëri synon të rrisë në mënyrë të qëndrueshme aksesin në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare për SME-të në zinxhirët e vlerave BAM dhe F&V duke forcuar cilësinë dhe kapacitetin e përputhshmërisë me standardet. Programi fokusohet në infrastrukturën e cilësisë dhe pajtueshmërisë, si dhe në kërkesat ekonomike, sociale dhe të qëndrueshmërisë.

KËRKESAT PËR EKSPORT NË VENDET E BE-SË¹

Kërkesat ligjore të BE-së dhe kërkesat shtesë të blerësve si pikë referimi ndërkombëtare

Kërkesat e BE-së për cilësinë konsiderohen si pikë referimi: përputhja e plotë me këto kërkesa në përgjithësi lejon eksportin në shumicën e tregjeve të tjera. Kërkesat ligjore për ndotësit dhe mbetjet janë veçanërisht strikte dhe blerësit në shumë raste kërkojnë parametra edhe më të rreptë.

Në raste të tjera, praktikat e prodhimit që lejohen ligjërisht, si rrezatimi, nuk pëlqehen nga konsumatorët, kështu që blerësit nuk pranojnë produktet e prodhuara duke zbatuar praktika të tilla.

Në përgjithësi, nga ana e eksportuesve, kërkesat më të vështira për t'u përmbushur janë ato të ofruara nga blerësi aktual, të cilat shpesh janë më të rrepta se standardet ligjore. Në disa raste, disa certifikime, të cilat janë vullnetare nga përkufizimi, kërkojnë kaq universalisht, kështu që në praktikë po bëhen të detyrueshme për të siguruar një blerës për sa i përket standardeve të cilësisë.

BE-ja ka vendosur një QI kompleks dhe disa mjete për të kontrolluar zbatimin e kërkesave ligjore. Mospërputhja e përsëritur me legjislacionin evropian të ushqimit nga një vend i caktuar mund të çojë në kushte më të rrepta të importit apo edhe pezullim të importeve nga ai vend. Këto kushte më të rrepta zakonisht përfshijnë një kërkesë për një certifikatë shëndetësore dhe një raport analitik testimi për një përqindje të caktuar të dërgesave nga vende të veçanta. Produktet nga vendet që kanë treguar mospërputhje të përsëritur janë vendosur në një listë të përfshirë në Rregulloren për Rritjen e Nivelit të Kontrolleve Zyrtare në Importe.

Vetëm një numër i vogël i produkteve të importuara dhe tregtuara në Evropë i nënshtrohen kontrolleve zyrtare (fizike), pasi përgjegjësia kryesore për sigurinë e tyre bie mbi operatorët komercialë (p.sh. importuesit). *Prandaj, importuesit kryejnë shumicën e kontrolleve të kërkuara për të siguruar që produktet janë të sigurt, dhe ata gjithashtu mund të kërkojnë certifikim dhe prova të tjera të cilësisë dhe sigurisë* (CBI, 2023).

Krahas kontrolleve kufitare, kontrollet zyrtare të ushqimit përfshijnë inspektime të rregullta që mund të kryhen në të gjitha fazat, nga importi deri tek shitja me pakicë. Në rast të mospërputhjes me legjislacionin evropian të ushqimit, rastet individuale raportohen përmes Sistemit të Sinjalizimeve të Shpejtë për Ushqimet dhe Ushqimet RASFF (shih më poshtë).

Evolucioni dhe tendencat në kërkesat ligjore të BE-së për produktet ushqimore dhe standardet vullnetare për importin e BAM-it të freskët dhe të tharë.

Parimet “Farm to Fork” brenda kornizës së marrëveshjes së gjelbër të BE-së

Kërkesat ligjore për importin e të gjitha produkteve ushqimore në BE modifikohen shpesh dhe po bëhen gjithnjë e më strikte, në përputhje me politikat e BE-së për sigurinë ushqimore. Në veçanti, normat për ndotësit (kryesisht metalet) dhe mbetjet (kryesisht PPP) pritet të bëhen gjithnjë e më të rrepta, si rezultat i aplikimit të komponentit “*Farm to Fork*” të politikës së *marrëveshjes së gjelbër të BE-së*.

Strategjia “Farm to Fork” synon të rrisë qëndrueshmërinë e të gjithë zinxhirit të furnizimit për sa i përket mjedisit, sigurisë ushqimore, sigurisë ushqimore dhe shpërndarjes së drejtë të të ardhurave përgjatë zinxhirit ushqimor, duke siguruar njëkohësisht përballueshmërinë e ushqimit.

Strategjia “Farm to Fork” synon reduktimin e ndjeshëm të ndikimit mjedisor të bujqësisë së BE-së deri në vitin 2030.

Reduktimi i përdorimit të pesticideve dhe antimikrobikëve, rritja e pjellorisë së tokës dhe zvogëlimi i humbjeve të lëndëve ushqyese në tokë dhe një objektiv i qartë për bujqësinë organike janë pikat kryesore të strategjisë “nga ferma në pirun”.

Parimet *Farm to Fork* vendosin një priorje të qartë dhe kufizuese për evoluimin e kërkesave ligjore për të hyrë në tregjet e BE-së.

Eksportuesit në BE nuk janë të detyruar të miratojnë menjëherë parimet nga ferma në pirun, megjithatë, miratimi i kësaj qasjeje do të ndihmojë në përafrimin me tregun e BE-së në të ardhmen e ardhshme.

Kodi i Sjelljes së KE-së dhe futja vullnetare e praktikave të qëndrueshme mjedisore dhe sociale. Përveç kufizimeve graduale që do të futen në kërkesat ligjore, Komisioni Evropian ka nisur një Kod Sjelljeje për të inkurajuar praktikat e qëndrueshme mjedisore dhe shoqërore midis prodhuesve dhe shitësve të ushqimit. Ai vjen si një nga rezultatet e para të Strategjisë Farm to Fork, e cila synon të përmirësojë qëndrueshmërinë e përgjithshme të sistemit evropian të ushqimit. Kodi i Sjelljes së BE-së përbëhet nga 7 objektiva aspiratorë, që synojnë zgjedhje më të qëndrueshme dhe të shëndetshme ushqimore:

- Dieta të shëndetshme, të balancuara dhe të qëndrueshme për të gjithë konsumatorët evropianë.
- Parandalimi dhe reduktimi i humbjes dhe i mbetjeve të ushqimit.
- Një zinxhir ushqimor neutral ndaj klimës në Evropë deri në vitin 2050 duke reduktuar përdorimin e energjisë dhe duke aplikuar zgjidhje të qëndrueshme të bazuara në bioekonomi duke kontribuar në një ekonomi rrethore.
- Një zinxhir ushqimor i optimizuar rrethor dhe me efikasitet të burimeve në Evropë duke përmirësuar efikasitetin e burimeve dhe duke rritur qëndrueshmërinë e paketimit të ushqimit dhe pijeve.
- Rritje ekonomike e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme, punësim dhe punë të denja për të gjithë.
- Krijimi i qëndrueshëm i vlerës në zinxhirin evropian të furnizimit me ushqime.

- Burime të qëndrueshme në zinxhirët e furnizimit me ushqime.

Çdo kompani (pavarësisht nga madhësia) e përfshirë në aktivitete ushqimore ose të lidhura me proceset ushqimore mund t'i bashkohet Kodit të Sjelljes së BE-së. Palëve të interesuara që dëshirojnë të nënshkruajnë Kodin u kërkohet të angazhohen për të për një periudhë afatgjatë (të paktën deri në vitin 2025) dhe të japin një raport vjetor në prill. Informacioni i angazhimit do të vihet në dispozicion të publikut dhe çdo palë e interesuar do të prezantojë progresin e tij të paktën një herë në vit në një platformë specifike dhe të dedikuar.

Rritja e numrit të standardeve vullnetare dhe standardeve private të supermarketeve

Një trend që ka ardhur në rritje që nga fundi i shekullit të kaluar, paralelisht me rritjen e rrjeteve të supermarketeve në treg, është kërkesa e këtyre pikave të fundit për kërkesat shtesë të përfshira në një standard të cilësisë së tyre, të cilat përdoren krahas certifikatave të tjera ndërkombëtare. Ndërsa disa nga këto standarde janë për përdorim të brendshëm vetëm në marrëdhëniet tregtare midis zinxhirëve të supermarketeve dhe furnitorëve, të tjerë, si Tesco Nurture, lëshohen për certifikim dhe përfshihen në skemat ekzistuese ndërkombëtare të certifikimit.

Këto standarde kanë evoluar me kalimin e kohës në përputhje me evoluimin e konceptit të qëndrueshmërisë, duke rritur kështu shtrirjen e tyre nga ana e prodhimit (GAP/IPM, GMP, HACCP) në një grup më të gjerë rregullash që mbulojnë çështjet mjedisore dhe sociale. Synimi kryesor i këtyre skemave është t'u ofrojë klientëve një garanci se produktet ushqimore nga furnizuesit e zinxhirit të supermarketeve rriten në një mënyrë të përgjegjshme për mjedisin. Për këtë qëllim, shpesh këto skema bazohen në zbatimin e kërkesave më kufizuese se ato të përcaktuara në legjislacion, p.sh. në lidhje me përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe kufijtë e sipërm të mbetjeve të produkteve për mbrojtjen e bimëve në produktet ushqimore. Për shembull, këto protokolle mund të përcaktojnë një përqindje maksimale të MRL në lidhje me ato të përcaktuara nga ligji, si dhe të përcaktojnë një numër maksimal të mbetjeve të pesticideve, megjithëse brenda MRL, siç është e zakonshme në zinxhirët gjermanë të supermarketeve (për shembull: maksimumi pesë mbetje).

Standardet më të zakonshme vullnetare dhe standardet private të supermarketeve të aplikueshme për BAM-të objekt të këtij studimi janë paraqitur në nënkapitullin 4.3.5 dhe Aneksin.

Kërkesat për BAM të freskët dhe të tharë

Kërkesat e përgjithshme

Tabela 1 jep një përmbledhje te temave që lidhen me kërkesat për eksport në BE të BAM të freskët dhe të tharë, të çështjeve kyçe përkatëse dhe të dispozitave ligjore referuese.

<i>Tabela. Eksporti i BAM-ve në BE: kategoritë e kërkesave, çështjet kryesore dhe legjislacioni</i>		
Kategoria e kërkesës	Çështjet kyçe	Normat e referencës
Gjurmueshmëria	<i>një hap prapa një hap përpara</i>; - Etiketimi me një tregues të origjinës dhe lotit të prodhimit; - Dëshmia e origjinës për prodhuesit jashtë BE-së	Reg. EC/178/2002 ² Komisioni Zbatues i Rregullores. (BE) 931/2011
Siguria e ushqimit <i>Higjiena e ushqimit</i> <i>Ndotësit</i>	- Aplikimi HACCP - Metalet; - Kimikatet; - Toksina;	Reg. (EC) 852/2004 (KE, 2004) Reg. (EC) 1881/2006 (KE, 2006)
<i>Mbetjet</i>	PPP, kimikate të tjera	Reg. (KE) 396/2005 (KE, 2005)
<i>Mikrobiologjike 1</i>	Kontaminime të zgjedhura mikrobiologjike të rrezikshme për shëndetin e njeriut;	Reg. (KE) 2073/2005.
<i>Trupat e huaj</i>	Tokë, insekte, papastërti.	Nuk ka rregullore specifike, zbatohen standardet e blerësve.
Etiketimi	Informacion për produktin, origjinën, gjurmueshmërinë, standardin e marketingut;	Reg. BE 1169/2011 (KE, 2011a).
Fitosanitare	- Certifikata”; - Dokumentacion shtesë për produkte dhe origjinë specifike;	Reg. (BE) 2019/2072. Rregullore shtesë për raste të veçanta.
Marketingu	Zbatimi i standardeve të cilësisë së BE-së dhe/ose UNECE;	Reg. (BE) 543/2011.
Aspekte të tjera	1) Ushqimi i rrezatuar: Tregimi “Ushqim i rrezatuar” në etiketë. 2) Ushqimi i ri: i zbatueshëm për produktet që nuk janë zakonisht në tregti përpara vitit 1997. 3) Produkte të kontaminuara nga radioaktiviteti.	Direktivat 1999/2/CE dhe 1999/3/CE. Direktivat 1999/2/CE dhe 1999/3/CE.
<i>Burimi: Shpjellim i autorit</i>		

(Vijon në faqen 13)

¹ Informacioni i përfshirë në këtë kapitull bazohet kryesisht në Udhëzuesin e Eksportit MAPs të Qendrës Ndërkombëtare të Tregtisë (Udhëzuesi i eksportit. Përbërësit dhe produktet e bimëve mjekësore dhe aromatike, Gjenevë, shkurt 2023), faqen e internetit të Qendrës për Promovimin e Importeve nga vendet në zhvillim (CBI), Access2Markets, kapitulli mbi sigurinë ushqimore të Komisionit Evropian (<http://food.ec.europa.eu>), legjislacioni përkatës i BE-së për ushqimin, sigurinë ushqimore, etiketimin, fito-sanitarin, gjurmueshmërinë dhe përmbledhjet e tij dhe, raporti i UNIDO GQSP “Gjeorgjia. Forcimi i vlerësimit të konformitetit për frutat dhe perimet. Studimi i zinxhirit të vlerës”.

² Rregulla specifike dhe shtesë janë paraparë për produktet me origjinë shtazore, ushqimin e kafshëve dhe bimët e gjalla

Eliminimi i tregtisë së paligjshme të produkteve të duhanit, Malaj në takimin e nivelit të lartë në Mal të Zi

Ministri i Financave, Petrit Malaj, mori pjesë në takimin e nivelit të lartë mbi masat e eliminimit të tregtisë së paligjshme të produkteve të duhanit në Ballkanin Perëndimor, i cili u zhvillua në Podgoricë të Malit të Zi.

Në këtë takim merrnin pjesë ministrat e Financave të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi; zv.ministri

Maqedonia e Veriut dhe Bosnja dhe Hercegovina përballen me sfida të ngjashme në lidhje me tregtinë e paligjshme të duhanit dhe ndikimin e rritjes së akcizës. Bashkëpunimi me këto vende është i rëndësishëm për të forcuar kapacitetet e mbikëqyrjes dhe për të siguruar një treg më transparent. Politikat e harmonizuara dhe kontrollet e përbashkëta me institucione brenda vendit por

kufitare; ashpërsimi i legjislacionit dhe ndëshkimeve; bashkëpunimi ndërkombëtar, ku Shqipëria ka forcuar bashkëpunimin me vendet e rajonit, BE-në dhe organizata si Interpol, Europol dhe SELEC dhe ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve.

Në një kohë që sfidat mbeten të mëdha, ministri theksoi se suksesi i këtyre masave varet nga zbatimi i tyre i rreptë dhe një luftë e vazhdueshme kundër korrupsionit që mund të lehtësojë këtë fenomen.

Ndërsa vuri në dukje faktin se Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në forcimin e sistemit të akcizës, përafrimin me kërkesat evropiane dhe përmirësimin e masave për të luftuar aktivitetet e paligjshme në tregun e duhanit, ministri tha se për adresimin e sfidave kërkohet përmirësim i politikave, forcim të mekanizmave të zbatimit dhe një bashkëpunim më të ngushtë mes institucioneve.

“Përmes një qasjeje të integruar ndërinstitucionale, që përfshin administratën tatimore, doganat, institucionet e shëndetit publik dhe forcat e policisë së shtetit, synojmë të krijojmë një mjedis të ekuilibruar dhe që garanton stabilitet tregtar të ndershëm dhe të sigurt”, u shpreh Malaj, ndërsa shtoi se qeveria shqiptare, me miratimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planit të Veprimit 2024–2027 si edhe sipas Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2025–2027, ka planifikuar masa për rritjen graduale të akcizës mbi produktet e duhanit dhe nënprodukteve të tij, me qëllim përafrimin me nivelet sipas Direktivës së BE-së 2011/64.

Në përfundim të fjalës së tij, ministri Malaj shprehu gatishmërinë për të forcuar partneritetin me vendet e rajonit dhe për të gjetur mënyra të reja për intensifikuar bashkëpunimin, duke përdorur teknologji më të avancuara, duke shkëmbyer më shumë informacion dhe duke përmirësuar kapacitetet për trajnime dhe analiza.



i Financave të Bosnjë Hercegovinës; kryeministri i Malit të Zi; përfaqësues të lartë nga Komisioni Europian dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë si dhe përfaqësues nga Banka Botërore, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Organizata Botërore e Doganave.

Diskutimet e pjesëmarrësve kishin në fokus angazhimin politik për eliminimin e evazionit tatimor dhe tregtinë e paligjshme të produkteve të duhanit në Ballkanin Perëndimor.

Në fjalën e tij, ministri Malaj vlerësoi organizimin e takimit dhe vuri theksin në nevojën për rritjen e bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe organizatave ndërkombëtare për të ndaluar fenomenin e tregtisë së paligjshme të produkteve të duhanit, si një problematikë që dëmton jo vetëm ekonominë përmes humbjeve fiskale, por që krijon edhe rreziqe për shëndetin publik.

“Në Ballkanin Perëndimor, shtete si Serbia, Mali i Zi,

edhe me partnerët kanë treguar se një qasje e koordinuar rajonale mund të ndihmojë në reduktimin e informalitetit dhe përmirësimin e të ardhurave fiskale”, u shpreh Malaj.

Ministri tha se autoritetet shqiptare, në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare, kanë intensifikuar kontrollet kufitare, operacionet kundër rrjeteve të kontrabandës dhe reformat në legjislacion për të ashpësuar ndëshkimet ndaj trafikantëve. E megjithatë, sipas Ministrit, për të qenë më efektive, lufta kundër kontrabandës së duhanit kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin përmirësimin e alternativave ekonomike për ata që përfshihen në këtë aktivitet të paligjshëm dhe zbatimin e rreptë të ligjit ndaj organizatorëve kryesorë të kontrabandës.

Ministri i Financave renditi disa prej masave konkrete që Shqipëria ka ndërmarrë në luftën kundër kontrabandës së duhanit, të cilat përfshijnë disa aspekte kryesore, si: fuqizimi i kontrolleve doganore dhe

Dita e Verës nxit tregtinë vendase - Zejtarët: Kjo ditë shërben për të reklamuar produktet tona

Dita e Verës mbush rrugët e Shqipërisë me gëzim, festime dhe aromën e ballokumeve.

Kjo festë tradicionale shënon ardhjen e pranverës,

ka edhe një ndikim ekonomik, duke nxitur tregtinë vendase.

Në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" ku u përqendruan



duke gjallëruar vendin me aktivitetet dhe panairë.

Por përtej simbolikës, ajo

kryesisht festimet në kryeqytet, zejtarë të ndryshëm shfrytëzuan këtë ditë për të reklamuar

produktet e tyre, ku nuk munguan as ato të agroturizmit.

“Qëllimi kyesor është reklamimi i produkteve, si psh glikoja e arrëes, misër apo çdo gjë tjetër që ne kemi në agroturizëm për tja treguar më nga afër qytetarëve.” “Edhe vjet kishte shumë punë, sot ndikoi pak koha, por prapë dhe disa e sotme kishte qytetarë të interesuar për produkte të ndryshme.” U shprehën disa nga zejtarët që kishin ngritur stendat tek bulevardardi “Dëshmorët e Kombit”.

Ballokumet, si ëmbëlsira kryesore e kësaj feste, shfaqëruan qytetarët në rrugë.

Por nuk munguan as vëroret, lulet dekorative, librat, produkte të ndryshme të agroturizmit dhe madje edhe bagëtiti e imëta.

Tjetër vatër me gripin e shpendëve në Durrës, Ministria e Bujqësisë: Mbi 1800 pula të ngordhura

(Vijon nga faqja 2)

Gjepalaj, Rashbull, Thumanë, Bubq, Prezë dhe Vorë, në zbatim të Urdhrit të Ministrit Nr. 240 datë 9.3.2025 “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla”, i cili përcakton:

– Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e Njësisë Administrative Sukth, Manëz, Katund i Ri, Maminas, Gjepalaj, Rashbull, Thumanë, Bubq, Prezë dhe Vorë.

– Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla, në territorin e Njësisë Administrative Sukth, Manëz, Katund i Ri, Maminas, Gjepalaj, Rashbull, Thumanë, Bubq, Prezë dhe Vorë.

– Lejimin e lëvizjes së

shpendëve të gjallë sipas tabelës 4, të shtojcës 5, të Urdhrit Nr. 177, datë 28.3.2023 “Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influencës Aviare”, vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar për në thertore, pasi është kryer testi i PCR-së dhe shpendët kanë rezultuar negativ ndaj Sëmundjes së Influencës Aviare dhe të jenë shoqëruar me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së shpendëve, në territorin e Njësisë Administrative Sukth, Manëz, Katund i Ri, Maminas, Gjepalaj, Rashbull, Thumanë, Bubq, Prezë dhe Vorë.

Shërbimi Veterinar Rajonal po mbikqyr dhe monitoron nëpërmjet gjurmimit dhe kampionimit edhe ferma të tjera të vogla familjare, prezente në zonën e mbrojtjes dhe të mbikqyrjes, për t'i dërguar ato pa vonës në Laboratorin e Referencës – ISUV.

Vetëm ditën e sotme janë monitoruar 211 ferma me 2958

krerë nga 5 grupe Veterinerësh Zyrtarë të Kontrollit të pranishëm në terren. Gjithashtu, është njoftuar Instituti i Shëndetit Publik, për të kryer procedurat e nevojshme për kontrollin dhe vlerësimin e riskut.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural udhëzon fermerët dhe shpendërritësit në të gjithë vendin të rrisin vigjilencën dhe të bashkëpunojnë me autoritetet, të marrin masa për zbatimin e biosigurisë në fermat dhe mjediset ku ata mbarështojnë shpendë, si dhe të kryejnë lëvizjen e shpendëve për qëllime tregtare, vetëm pasi të jenë autorizuar nga Veterineri Zyrtar i Shërbimit me Certifikatën Veterinare të Lëvizjes së Kafshëve.

Për cdo rast dyshimi, kërkohet komunikimi i menjëhershëm me shërbimin veterinar rajonal në numrin e gjelbër 08003366, ose në adresën e e-mail: info@akvmb.gov.al dhe evitimi i kontaktit me shpendët e dyshuar.

Braçe: Do vazhdoj betejën për TVSH-në e bujqësisë

Deputeti i Partisë Socialiste, Erion Braçe shprehet se beteja e tij për fshatin dhe bujqësinë nuk do të ndalet.

Në një postim në rrjetin e tij Facebook, Braçe përmes një video shprehet se nuk do të pyesë për ministrat që flenë, vegjetojnë, mendohen 1 vit, 2, 3, 6 vjet e që vijojnë të mendohen pa bërë asgjë duke e lënë fshatin nën harresë. Ndër të tjera, ai tha se do të vijojë betejën për TVSH-në e bujqësisë.

Tirana ka fshat! Pooo ka fshat! Fshati i Tiranës prodhon! Është prodhuesi i dytë bujqësor e blegtoral në vend! Beteja për fshatin, prodhimin e fshatit është beteja e dytë për të cilën do jem



në Kuvend! Janë dy beteja në një; E para-nga Rrogozhina, Kavaja ne Shëngjergj, nga Kamza ne Kërrabë, duhet të mbrojmë token bujqësore;

Ky qark nuk ka me nevojë për beton, ka nevojë për fshatin; ne nuk mund t'i zhdukim Tiranës fshatin; ritmi i betonit po zhbën fshatin; ky qark ka nevojë që fshati të prodhojë ushqim të freskët bujqësor e blegtoral, nuk ka nevojë të importojë që t'i japë tokë betonit.

E dyta-do vijoj betejën për TVSH-në e bujqësisë, atë që në 6 vite ka bërë dëme kolosale në

bujqësi e blegtori; do vijoj betejën kundër skemës së rehatit në Bujqësi e Blegtori, skemë që bën sikur ndihmon por që nuk nxit prodhimin në rendimet e cilësi; do barazojmë TVSH e do subvencionojmë çdo kilogram prodhim në fund të kësaj beteje. Nuk jam vetëm jooooo!-shprehet Braçe në video.

Nga ana tjetër ai ka përmendur dhe deputetët e zonave rurale, ku është shprehur se do e bëjë bashkë me ta.

‘Është një beteje që do e bëjë me Xhemalin, Tonin, Etjenin, Ornelon, deputet sot në fshatin e Ti-

ranës e candidate sërish, cilindo tjetër që do të na bashkohet për fshatin, popullin e tij, ushqimin e mirë e të freskët të vendit!

Do e bëjmë duke luftuar fort, akoma me fort pa pyetur me për ministra qe flenë, vegjetojnë, mendohen 1 vit, 2, 3, 6 vjet e qe vijojnë të mendohen pa bere asgjë e duke lenë fshatin nen goditje! Është beteja qe i kam kushtuar jetën! Nga Rrogozhina, Kavaja, Ndroqi, Peza, Arbana, Bultica, Kashari, Vora, Preza, Domja, Baldushku, Picalla, Petrela, Bezhiuta, Iba, Farka, gjithë nen Dajti deri ne Shengjergj, ka nevojë për këtë beteje! Unë di ta bej këtë beteje”, shkruan Braçe në postimin e tij. - përfundon Braçe.

AGROTURIZËM

Bujqësia dhe agroturizmi, Rama: Dy linja financimi, nxitje agropërpunimit

Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim në Kuçovë me përfaqësues të bizneseve të vogla dhe të mesme të zonave rurale, të cilët i informoi mbi dy linjat e reja të financimit për zhvillimin rural, kredinë e butë dhe garancinë sovranë.

Rama theksoi se këto dy linja të reja do të lehtësojnë aksesin në financa të sipërmarrësve të vegjël e të mesëm në fshat, me qëllim rritjen e investimeve në sektorët prioritarë si prodhimi bujqësor e blegtoral; mekanizim e inovacion; agropërpunim dhe infrastrukturë agroturistike.

Kryeministri theksoi se “kredia e butë me një linjë financimi 250 milionë euro dhe me normë interesi 3.5%, e kombinuar me Garancinë Sovrane, e ul normën e interesit në 2% dhe mbulon kolateralin deri në 70%”.

Kryeministri theksoi se nevoja për financim për agroturizmin është e vazhdueshme, ndërsa nxitja sipërmarrësve të aplikojnë në dy instrumentet e reja të financimit.

“Kjo duke u nisur nga linja kryesore e financimit që është linja e Bankën së Shqipërisë duke vendosur 250 milionë euro në shërbim të bizneseve të vogla dhe të mesme me fokus te bujqësia. Kur vjen puna te fokusi i bujqësisë agroturizmi

është një nga komponentët, pasi janë edhe serrat, blegto-ria dhe agropërpunimi”, tha Rama.

Kryeministri kërkoi nga

ambicioz jo vetëm për tregun e brendshëm por edhe për jashtë. Jo për masivitet, por për supercilësi dhe origjinalitet. Kredia me 2% është fantastike me



sipërmarrësve që të mendojnë edhe për agropërpunimin në funksion të rritje së biznesit dhe daljes në treg me produktet e tyre.

Rama veçoi produktet që prodhohen nga disa agroturizme në vend si “Chestnut Hill”, “Fustanella”, apo “Çobo”, ndërsa theksoi se pavarësisht se ato janë produkte fantastike nuk janë ende në masë për të dalë në treg.

“Më ka bërë përshtypje në Zvicër ku një vaj ulliri i prodhuar në Shqipëri me një shishe të vogël kishte një çmim 5-6 herë më të lartë se tregu. Ishte produkt special. Tregu i kërkon këto, ndaj duhet të jeni

70% të garancisë mbi kolateralin”, tha ai.

Kryeministri solli në vëmendje shembullin e “Chestnut Hill” në malet e Tropojës, që sipas tij, është shembulli që kthen përmbyes edhe një ekuacion, sipas së cilit është e pamundur të bësh bujqësi e të gjesh treg duke qenë larg territoreve dhe hapësirave ku zhvillohet bujqësia.

“Nëse ke një agroturizëm e sjell vetë tregun te dera jote. Chestnut Hill është një destinacion i mahnitshëm në majë të maleve aty ku jo pula ha gurë, por guri ha pulën dhe ku askujt nuk do t’i binte rruga por që sot shkohet me rezervim”, shtoi ai.

“Paketa e Maleve”, Rama: Kapërcyem kalvarin për investime në mungesë të letrave të pronësisë

Kryeministri Edi Rama u ndal te “Paketa e Maleve”, e cila sipas tij mundëson in-

vestimin në shumë zona në veri apo në jug nuk është pranuar ligji 7501 dhe kanë qëndruar në

këtë, por na ka shfaqur komplikime. Ndaj këtu hapim një korsi paralele që mund të vazh-



vestimin edhe në mungesë të letrave të pronësisë, vetëm me një konfirmim nga këshilli bashkiak.

Gjatë një takimi në Kuçovë me përfaqësues të bizneseve të vogla dhe të mesme të zonave rurale, Rama u shpreh se përmes Paketës së Maleve kemi kapërcyer me ligj, jo me fjalë, të gjithë kalvarin e përpjekjes sidomos të atyre në emigracion për të investuar në mungesë të letrave të pronësisë.

“Kjo si rezultat i faktit se

tokat e të parëve. Nuk kanë konflikte me njëri-tjetrin përgjithësisht por e kanë të pamundur që të marrin tokën”, tha Rama.

Kryeministri theksoi se për këtë çështje është bërë edhe një ligj i posaçëm që cilido që do të investojë në tokën e vetë mund ta bëjë thjesht me një dëshmi të konfirmuar nga këshilli bashkiak.

“Dihet se ka këtë territor dhe nuk ka konflikte me fqinjët, por edhe se nuk hyjnë te ligji 7501. Ligji 2020 u bë për

dojë investimin e vetë pa pasur nevojë t’i ketë të gjitha dokumentet, që ndërkohë do t’i bëjë avash avash me ligjin 2020, por duke marrë me këshillin bashkiak konfirmimin se kjo është toka e e tij”, tha Rama.

Mbi atë bazë, Kryeministri theksoi se me projektin merr lejen direkt dhe fillon punën. “Ndërkohë edhe me linjën e financimit kjo na jep mundësinë të shkojmë shumë më përpara me zhvillimin e agroturizmit dhe agropërpunimit”, shtoi ai.

Denaj: Projektojmë 1 mijë agroturizma në 2030, katalizator të zhvillimit rural

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, deklaroi se, “me një linjë financimi 250 milionë euro, e kombinuar me Garancinë Sovrane, që mbulon 70 % të kolateralit, mbështesim investimet në agroturizëm, si katalizator të zhvillimit rural në të gjithë vendin”.

E pranishme në agroturizmin “Hani i Qerosit” në Kuçovë, gjatë takimit me përfaqësues të bizneseve të vogla dhe të mesme, Denaj vlerësoi agroturizmin si një nga sektorët më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomi të vendit.

“Para 5 viteve nuk kishte asnjë agroturizëm dhe pikat e para të këtyre sipërmarrjeve nisën në Berat, por dhe zona të tjera të Shqipërisë ku falë dhe financimit të qeverisë me 20 milionë euro u mbështetën 122 agroturizma. Sot kemi 300 njësi akomoduse në zonat rurale dhe parashikojmë të shkojmë në 1 mijë të tilla në 2030 dhe ky projektion falë paketës së financimit 250 milionë euro me kredi të butë që mbështet investimet në këtë sektor”, tha Denaj.

Ajo vlerësoi punën e fermerëve dhe agrobiznesit për ngjytjen e emrit të prodhimeve “made in Albania”, në tregjet ndërkombëtare teksa shtoi se

ka ende për të çuar më tej zhvillimin e sektorit.

Denaj tha se, kjo paketë e rëndësishme financimi po konsultohet edhe me grupet e

nancimet nga Skema Kom-bëtare dhe Skema e Investimeve, shuma shkon në 23 milionë euro investime në mbështetje të bujqësisë dhe



interesit, ndërsa njoftoi se kanë filluar aplikimet për kredinë e butë.

“Një financim 250 milionë euro që lëvrohet nga bankat e nivelit të dytë me normë interesi nga 2% deri 3.5%, zbatohet për herë të parë në sektorin e bujqësisë. Në qershor përfundojmë edhe garancinë sovranë, që do të mbulojë 70% të kolateralit me fondet e shtetit, duke siguruar edhe një normë të ulët interesi në 2%”, tha ajo.

Denaj vuri në dukje se, vetëm në Qarkun e Beratit vitet e fundit ka 10 milionë euro investimeve.

“Po të përfshijmë edhe fi-

agroturizmit vetëm për këtë qark”, u shpreh ministrja.

Sipas saj, agroturizmet janë nukli i parë i zinxhirit të vlerës. “Ne sot mesatarisht llogarisim që një agroturizëm bën bashkë 22 familje dhe atë që ne themi bashkim i operatorëve, ndodh automatikisht në agroturime ku mesatarisht 22 familje me 11 ha, punojnë për një agroturizëm që do të thotë një rimilitarizim i plotë edhe i bujqësisë në këto zona, teksa 50% e të punësuarve janë të rinj dhe 70% janë zonja që ruajnë dhe zhvillojnë traditën dhe kulturën autoktone”, deklaroi Denaj.

Si duhet të përmirësohet digjitalizimi në turizëm? - Sitet kulturore të Shqipërisë në aplikacione për më shumë vizitorë

Strategjia e Specializimit Inteligent 2024-2030, ka në fokus nxitjen e inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë dhe jo vetëm, përmes ndërhyrjeve publike dhe private. Një nga pikat e kësaj strategjie është nisma gjithëpërfshirëse për përmirësimin digjital të turizmit. Synimi i kësaj nisme, është shfrytëzimi i fuqisë transformuese të realitetit virtual dhe të platformave digjitale gjithëpërfshirëse për të pasuruar përvojën e turistëve në nivele të ndryshme.

Peizazhet dhe trashëgimia e pasur kulturore e Shqipërisë, do të mund të ofrojnë një


mundësi unike për të kombinuar turizmin tradicional, me teknologjinë moderne. Përmes kësaj, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe pse jo promovimi i ofertave turistike të Shqipërisë duke zhvilluar harta interaktive online apo aplikacione të dedikuara mobile.

Në këto mjete digjitale, pritet që të ofrohet një navigim i lehtë në sitet turistike të Shqipërisë, të cilat do mund të jenë të pasuruara me përmbajtje multimediale si guida audio, klipe video dhe tregime interaktive për të interesuarit.

Përmes kësaj nisme, Shqipëria nuk promovon vetëm turizmin, por ajo synon të krijojë

një përvojë gjithëpërfshirëse dhe të pasur për vizitorët, që shfrytëzon inovacionin digjital për të theksuar bukurinë natyrore dhe pasurinë kulturore të saj. Qëllimi është ta bëjë Shqipërinë një destinacion të domosdoshëm në hartën digjitale globale, duke tërhequr një audiencë më të gjerë dhe duke nxitur një lidhje më të thellë mes vizitorëve dhe trashëgimisë së pasur shqiptare. Ky bashkim strategjik i teknologjisë dhe turizmit pritet të nxisë rritjen ekonomike, të përmirësojë ruajtjen e kulturës dhe të transformojë perceptimin e Shqipërisë si një pionier në turizmin digjital.





Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



PORTRET

Promovohet botimi më i ri Shefqet Mekos - Romani “Rënia” portretizon rrënimin e shoqërisë në vitet '90

Është promovuar në Tiranë libri më i ri i shkrimtarit dhe publicistit gazetarit të njohur të ish Radio Tiranës, Shefqet Meko botuar nga Shtëpia Botuese “Mediaprint”. Salla në Qendrën Kombëtare të Librit e tejmbushur nga shkrimtarët, lexues dhe miq të autorit që ishin pjesë e këtij eventi të veçantë, deshmoj jo vetëm mallin dhe dëshirën për të patur pranë Shefqetin, por edhe sjelljen e lexuesit shqiptar për të marrë romanin “Rënia”. Pjesëmarrësit e shumtë e vlerësuan krijimin e Mekos, që me një gjuhë brilante përshkruan periudhën e ndryshimit epokal të regjimeve, nga ai komunist, në demokracinë e ditëve të para. Botuesi

i “Mediaprint” falenderoi autorin që e përzgjodhi për këtë botim të spikatur. Të pranishmit që morën fjalën, Ahmet Prenci, Marash Mirashi, Arben Çeku, prof. Xhevat Lloshi, por dhe Agim Baçi e Behar Gjoka, Liridon Mulaj, e zbërthyen përmbajtësisht dhe teorikisht esencën e romanit “Rënia”, të cilin e vlerësuan edhe si autobiografik (të fshehur).

Atë e quajtën edhe roman kujtesë, një pasqyrë të situatave të kohës dhe personazhit kryesor. Ndërsa në këtë takim të pranishmit morën fjalën për të ndarë edhe përjetime nga leximi, si dhe nga ngjarjet me Shefqet Mekon. Pjesëmarrës në takim ishin edhe

shkrimtari, diplomati dhe politikani Besnik Mustafaj, ish-ministri Luftër Xhuvëli, Prof. Gjok Uldedaj etj. Autori Shefqet Meko pas falenderimeve, theksoi se romani i tij mishëron dëshirën për të pasqyruar realitetin ngjarjet e kaluara në kapërcyell të epokave.

Romani “Rënia” përçjell emocion dhe befasi tronditëse, duke portretizuar rrënimin e shoqërisë shqiptare të viteve '90. Përmes një gjetjeje mjaft të arrirë artistike, drama e personazhit kryesor, Maks Prifti, ndërthuret me atë të një shoqërie të zhgënjyer e të nëpërkëmbur që ndodhet në prag të ekzistencës së saj.

Romani “Rënia” i Shefqet Mekos - Dëshmi autentike letrare në një libër që do t'i mbetet letërsisë shqipe

Nga: Marash Mirashi

Tirana e fundit të viteve tetëdhjetë. Mes një uniformiteti vstar të panoramës kryeqytetase, nuk degjohet ne ajër as këmbanë e as namaz, te paktën si simbole të besimit njerëzor. Në këtë atmosferë përzhitëse, një djallë



ri i dashuruar, pedalon një biçikletë rrugëve të kryeqytetit shqiptar ku pa e kuptuar as vetë, zija e kësaj biçiklete bëhet këmbana e një kohe të shurdhër. Ai pedalon dhe i bie ziles si simbolikë e një idealizmi që më vonë do të

Një unazë që rrokulliset dhe një pedalim drejt një rrethi vicioz të fundit të absurdit komunist dhe një zile që nëse e marrim të mirëqenë, mund të konsiderohet edhe si një-sia matëse e intensitetit emocional që romani “Rënia” na e dhuron gjatë leximit të tij, duke marrë njëherësh një kënaqesi estetike, çka është edhe qëllimi i artit të shkruarit, gjithmonë nëse ka një qëllim përse në shkruajmë, apo shkrimi është thjesht nënvetëdija jonë, apo rrathët e imagjinatës janë gjithçka që vetë lexuesi e percepton si një formë të artit.

Dua të nënvizoj se teksti i Shefqet Mekos, në romanin me titull mjaft intrigues “Rënia” pas një konsultimi plot ethe deri në futjen në shtyp, na provon padyshim, variantin e dytë, pasi kemi të bëjmë me një vepër letrare të shkruar me art dhe imagjinatë. Autori ka mundur t'ia dalë në pamje të parë lehtësisht, pasi libri lexohet rrjedhshëm, por në një pikëpamje të dytë, autori ka patur një betejë të madhe e të vështirë me veten, pasi është pikërisht ai që pedalonte biçikletën rrugëve të Tiranës dhe mbante varur në gjoks për shumë kohë unazën-medaljonin e tij fatkeq që siç e shohim në mbyllje të romanit, përfundon në fundin e detit për t'u shndërruar në koralin e kujtesës së hidhur, teksa ka marrë me vete në tragjizmin e saj, të gjitha brengat që një dashuri

je që po e çonte gjithçka në rënie. Dua të them se unë e kam parë me sytë e mi biçikletën dhe e kam dëgjuar zilen e saj për ta transkriptuar atë si një këmbanë. Romani rënia që nga faqja e parë e deri tek ajo e fundit është njëra prej dëshmive letrare që në një këndvështrim stilistik gazetari, i vjen sot lexuesit si pjesë e pazëllit ende të paplotësuar në letërsinë shqipe, ndonëse kemi disa vepra letrare që e evokojnë këtë periudhë gri të Shqipërisë.

Prandaj edhe romani i mikut tonë Meko, është i një rëndësie të veçantë, si një kontribut i vetëdijes letrare të tij. Njoh me detaje disa nga realitetet e sendërtuara në letërsi të këtij romani. Një qytezë e bukur studentore plot ëndrra dhe një Tiranë zyrtare që nuk ua kish nge në ëndërrave. Njoh një pjesë të mirë të personazheve kryesore, dytësore apo periferike të këtij romani. Diku shoh veten time, idealizmin dhe rebelizmin tim dhe të lolegut Meko, përballë një muri prej gome, ku sa herë e grisheshim ta godisnim, ktheheshim sërish pas, në pozicionin fillestar, të gatshëm për të sulmuar përsëri fatin tonë prej gome.

Autori i romanit “Rënia”, një gazetar i njohur i para dhe i pas viteve nëntëdhjetë, madje kryeredaktor i një gazete studentësh, ia ka arritur që përvojat e tij jetësore



sendërtohej në një vepër letrare, në romanin “Rënia”.

Gjatë kohës që unë po e lexoja këtë libër mbi qelqin teknologjik të një laptopi, më bëhej se dëgjoja dy tingëllima, atë të unazës së kthyer brutalisht, që pasi përshkon të gjithë shkallaret e një pallati të kohës së komunizmit, pushon në katin e parë të tij, si dhe zilen e biçikletës që bie e bie papushim.

e papërfunduar do të mund t'i dhuronte ëndrrave të një djali të ri që bëhet dëshmitar i një sistemi që vret gjithçka për të mbijetuar vetë.

Parë në këtë prizëm, Maks Prifti, alias Shefqet Meko, është një protagonist elitar i përpjekjeve për ta diagnostikuar e pse jo edhe për ta shëndoshur sistemin nga brenda, e nga ana tjetër është dëshmitar i një zhgallitje-

në këtë periudhë të bukur por dhe delikate të jetës, ti sjellë jo thjesht si një dëshmi autentike të kohës, por si dëshmi e artit të shkruarit, duke i dhënë vetë librit karakterin e një romani sa autobiografik po aq edhe karakterin e një romani historik. Lehtësia me të cilën Shefqeti ka

AGROTURIZËM

AKZM apel për mbrojtjen e specieve të egra, thelbësore për ekosistemin

Në Ditën Botërore të Jetës së Egër, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura bën apel për mbrojtjen e specieve të kësaj natyre, të cilat janë thelbësore për ekosistemin.

Në një postim në rrjetet sociale AKZM ndau një video “nga banorët më të rëndësishëm dhe të habitateve tona natyrore, të cilët i sjellim për ju në një kartolinë imazhesh nga jetesa e tyre e qetë në natyrë”.

“Sot është një moment për të reflektuar mbi bukurinë dhe rëndësinë e biodiversitetit në Zonat e Mbrojtura, por jo vetëm. Në këtë ditë të veçantë, bëjmë një apel për qëndrueshmëri dhe mbrojtjen e specieve të egra, të cilat janë thelbësore për ekosistemin dhe të ardhmen tonë”, shkruan AKZM.

Në Shqipëri, me miratimin e ligjit për moratoriumin e gjuetisë, numri i specieve të

kafshëve të egra është rritur ndjeshëm në të gjithë vendin.

Dita Botërore e Kafshëve të Egra është një ngjarje

të përmbushur nevojat tona, nga ushqimi te karburantet, ilaçet, strehimi dhe veshja. Miliona njerëz gjithashtu



globale, që mbahet çdo vit më 3 mars. Ajo feston dhe rrit ndërgjegjësimin për kafshët dhe bimët e egra të botës. Ne, të gjithë mbështetemi në kafshë të egra dhe burime të bazuara në biodiversitet për

mbështetjen e natyrës si burim i jetesës dhe mundësi të tyre ekonomike. Si e tillë, kjo ditë synon të rrisë ndërgjegjësimin për rolin jetik që ka jeta jonë e egër në mbështetjen e planetit.

AKZM dhe universiteti “Luigj Gurakaqi”, projekte kërkimore për ruajtjen e biodiversitetit

Ndërthurja e kërkimit shkencor dhe menaxhimi i qëndrueshëm i zonave të

cisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Universitetit të Shkodrës Prof. Dr. Blerta Dragusha.

Në një postim në rrjetet sociale, AKZM thekson se “kjo marrëveshje është një urë e re bashkëveprimi, e cila do të sigurojë shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencave, zhvillimin e praktikave mësimore për studentët dhe bashkëpunimin në projekte kërkimore që mbështesin ruajtjen e biodiversitetit dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm”.

Përmes këtij partneriteti, palët riafirmojnë angazhimin e tyre për të fuqizuar kapacitetet akademike dhe institucionale në fushën e mbrojtjes së natyrës, duke sjellë kontribute konkrete në zhvillimin e politikave dhe praktikave mjedisore në Shqipëri.



mbrojtura është në qendër të një marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar mes Agjen-

Marrëveshja u nënshkrua nga drejtoresha e AKZM-së, Daniel Pirushi dhe zëvendësrektorja e

Shtegu i Ngjyrave, një perlë natyrore në Parkun “Korab-Koritnik”

Shtegu i Ngjyrave, ose ndryshe shtegu “Liqeni i Kallabakut-Kallabak-Çajë”, është një nga destinacionet më të bukura natyrore që ofron Parku Natyror “Korab-Koritnik”, i njohur për peizazhet e tij mahnitëse dhe biodiversitetin e pasur.

Ky itinerar njihet gjithashtu si një tur botanik, pasi ofron një shumëllojshmëri bimësh endemike dhe subendemike, duke e bërë atë një atraksion të veçantë për turistët dhe dashamirësit e natyrës.

Me një kombinim unik të ngjyrave dhe panoramave

mahnitëse, Shtegu i Ngjyrave mbetet një destinacion i veçantë



për eksploruesit dhe adhuruesit e ekoturizmit në Shqipëri.

Aplikimi për stacionet e plazhit shtyhet deri më 31 maj

Qeveria ka shtyrë deri më datë 31 maj 2025 afatin për subjektet private që duan të aplikojnë për të lidhur kontratën e qirasë për të ushtruar veprimtarinë e tyre në stacionet e plazhit.

Këshilli i Ministrave miratoi sot disa shtesa dhe ndryshime në vendimin “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

Sipas vendimit të miratuar në mbledhjen e qeverisë, subjektet private që duan të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në stacionet e plazhit, kanë afat deri më 31 maj 2025 për të aplikuar për të lidhur kontratën e qirasë për përdorimin e hapësirës së plazhit.

Të drejtën për të përdorur hapësirën e plazhit e kanë subjektet private që janë të kategorizuara si: “Bujtinë, Fjetinë (Hostel), Hotel, Resort, Qendër kurative, Fjetje dhe mëngjes, Apartament/vilë”, që kanë jo më pak se 5 dhoma dhe “Bllok apartamentesh”, që janë dy ose

më shumë apartamente në të njëjtën vendndodhje dhe menaxhohen nga i njëjti sipërmar-

mandati i pagesës dhe caktohet plan-vendosja përkatëse të stacionit të plazhit.



rës turistik, që kanë jo më pak se 5 dhoma.

Në vendimin e qeverisë thuhet se faza e dytë e aplikimit të subjektit, për stacion plazhi do të jetë brenda datës 30 prill, nga 30 marsi që ka qenë caktuar në rregullore, pra është shtyrë me një muaj.

Faza e parë është ajo e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit, ndërsa në të dytën saktësohet aplikimi, gjenerohet

Të gjitha subjektet e interesuara mund të kryejnë aplikimin e tyre në portalin e-Albania duke kërkuar shërbimin “Aplikim për ushtrimin e veprimtarisë së stacion plazhi”.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Pas tunelit të Murrizit hapet rruga Maqellarë-Peshkopi - Shkurtohet distanca Dibër - Tiranë, nxitet turizmi dhe lehtësohet qarkullimi

Pas hapjes së tunelit të Murrizit, i cili lidh Dibrën me Tiranën dhe shkurton distancën me 2 orë, kryeministri Edi Rama dhe zëvendëskryeministria dhe ministre e MIE Belinda Balluku, kanë pohuar se muajin e ardhshëm do të hapet rruga Maqellarë-Peshkopi. Punimet në këtë kantier kanë avancuar dhe janë në fazën përmbyllëse. Segmenti rrugor Maqellarë-Peshkopi, është pjesë e Rrugës së Arbërit. Projekti është 8.4 kilometra, rreth 2.4 km më i shkurtër se rruga ekzistuese. Kjo vepër e rëndësishme, pritet nga të gjithë dibranët, por edhe vizitorët, të cilët kanë qenë të shumtë gjatë 2024 dhe do

të jetë jo vetëm një rrugë me kushte të përmirësuara që është një kategori C2 e përmirësuar, por nga ana tjetër do të ketë shkurtim të distancës së përshkimit. Nga 11 kilometra që sot lidhet Maqellara me Peshkopinë, do të shkohet me 2.4 kilometra më dhe është trase e re.

Punimet shkurtojnë distancën, por mbi të gjitha kanë eliminuar një pjesë të rrugës që ishte shumë e vështirë dhe me kthesa. Ky investim, do të bëjë që rruga nga dalja e Tiranës deri në Peshkopi të përshkohet për 1 orë, ndërsa do të nxisë fluksin e qarkullimit të vizitorëve dhe turistëve në këtë zonë. Prej ditës së djeshme, qytetarët e

verilindjes së Shqipërisë kanë akses të përshkojnë të plotë “Rrugën e Arbrit”, e cila lidh Tiranën me Dibrën.

Këtë të premte, u inaugurua tuneli i Murrizit, me gjatësi 3.8 kilometra, që është dhe vepra më e rëndësishme e projektit. pTuneli kryesor ka dy korsi lëvizje me 3.75 metra si dhe trotuare me gjerësi 1.5 metra. Ai lidhet me tunelin e emergjencës me anë të 11 galerive.

Me hapjen e tunelit të Murrizit për qarkullimin e mjeteve, pas 6 vitesh punimesh, udhëtimi nga Tirana në Dibër dhe anasjelltas, pritet të jetë rreth 2 orë.

Via Ferrata në Kuç, hap i madh për turizmin e aventurës

Ndërhyrjet në infrastrukturën turistike të aventurës, synojnë të nxisin më tej eksplorimin e bukurive natyrore të Shqipërisë.

Një projekt inovativ ka marrë jetë përmes Platformës së Inovacionit në Turizëm (TIP), ku Çeta Hiking fitoi çmimin e parë për të realizuar Via Ferrata-n në Kuç, në rajonin e Vlorës.

Via Ferrata e parë në Shqipëri po ndërtohet për ngjitje në zona shkëmbore me instalime hekuri.

100 metrat e parë të këtij shtegu janë financuar nga GIZ, si dhe 150 metra shtesë u financuan nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH). Përmes një Memorandumi Mirëkupa-

timi mes GIZ, FSHZH dhe Bashkisë Himarë, ky produkt i ri po bëhet realitet.

E vendosur në një zonë ende të pashfrytëzuar e të paprekur nga turizmi, Via Ferrata në Kuç do të krijojë një eksperiencë unike përpara se turistët të zbresin drejt bregdetit jugor.

Ky zhvillim jo vetëm që do të diversifikojë ofertën turistike në rajon, por gjithashtu do të krijojë mundësi të reja ekonomike për banorët lokalë dhe operatorët turistikë, duke i dhënë zonës një dimension të ri tërheqës për vizitorët dhe aventurierët.



Via Ferrata e parë në Shqipëri, merr udhë në Kuç, Himarë!

AGROTURIZËM

Përcaktohen rregullat për shfrytëzimin e strukturave akomoduese për qëllime tatimore

Këshilli i Ministrave vendosi përcaktimin e rregullave për shfrytëzimin e strukturave akomoduese dhe të nivelit minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të tyre, në funksion të deklarimit për qëllime tatimore, gjatë vitit kalendarik.

Sipas vendimit, procedurës së deklarimit të kapacitetit të strukturave akomoduese dhe nivelit të shfrytëzimit të tyre u nënshtrohen strukturat akomoduese në kategoritë e mëposhtme: “Bujtinë”; “Bllok apartamentesh”; “Motel”; “Fjetje dhe mëngjes”; “Hotel”; “Hotel i shpërndarë”; “Resort”; “Strukturë akomoduese e trashëgimisë kulturore”.

Periodhë e shfrytëzimit është periudha e ndarë në dy periudha sezonale, përkatësisht, nga data 1 maj deri në datën 30 shtator dhe nga data 1 tetor deri në datën 30 prill të çdo viti. Në përllogaritjet, për efekt të kapacitetit të shfrytëzimit, ditët që merren në konsideratë janë ditët kalendarike gjatë kësaj periudhe.

Niveli i shfrytëzimit të strukturave akomoduese bazohet në të dhënat e deklaruar nga sipërmarrësi i strukturës akomoduese për shfrytëzimin e kapacitetit të saj. Ky nivel llogaritet duke marrë në konsideratë numrin e përgjithshëm të dhomave të shfrytëzuara përgjatë periudhës së shfrytëzimit në raport me kapacitetin e plotë të strukturës akomoduese gjatë kësaj periudhe. Mënyra e llogaritjes së kapacitetit dhe niveli i shfrytëzimit të një strukture akomoduese paraqiten në mënyrë të detajuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Në vendim thuhet se niveli minimal i shfrytëzimit të strukturës akomoduese është; jo më pak se 65 % e kapacitetit të strukturës akomoduese për periudhën nga data 1 maj deri në datën 30 shtator; jo më pak se 30 % e kapacitetit

të strukturës akomoduese për periudhën nga data 1 tetor deri në datën 30 prill.

Kjo vlerë llogaritet si me-

satare e nivelit minimal të shfrytëzimit përgjatë periudhës së shfrytëzimit.

Në rastet kur ka ndry-



shime të kapacitetit të strukturës akomoduese, sipërmarrësi ka detyrimin të deklarojë ndryshimet e kapacitetit të strukturës akomoduese, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e ndryshimit të kapacitetit të strukturës.

Ministria përgjegjëse për turizmin, brenda muajit shkurt të çdo viti, u dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe njësisë së qeverisjes vendore, që administron territorin ku ndodhet struktura akomoduese, të dhënat e deklaruar nga sipërmarrësi, sipas parashikimeve të pikës 10, të këtij vendimi.

Në rast të ndryshimit nga ana e sipërmarrësit të kapacitetit të strukturës akomoduese, ministria përgjegjëse për turizmin, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, ua dërgon Drejtorisë së Përgjithshme

të Tatimeve dhe njësisë së qeverisjes vendore, që administron territorin ku ndodhet struktura akomoduese, të dhënat e deklaruar nga sipërmarrësi.

Përgjithimisht, për vitin 2025, deklarimi i sipërmarrësit pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe ministria përgjegjëse për turizmin u dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe njësisë së qeverisjes vendore, që administron territorin ku ndodhet struktura akomoduese, të dhënat e deklaruar nga sipërmarrësi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të deklarimit nga sipërmarrësi.

Për zbatimin e vendimit ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin, ministria përgjegjëse për financat, administrata tatimore dhe sipërmarrësit e strukturave akomoduese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Romani “Rënia” i Shefqet Mekos - Dëshmi autentike letrare në një libër që do t'i mbetet letërsisë shqipe

(Vijon nga faqja 10)

operuar me ngjarjet, gjeografinë dhe personazhet, të forcojnë bindjen se pas dy romaneve të suksesshëm “Saga përtej Atlantikut” dhe “Viza Amerikane”, nuk kish sesi romani “Rënia” të mos ishte një kapërcim i këtyre librave të mëparshëm, duke shënuar një tjetër cak në letërsinë që autori bën personalisht, por dhe në një tjetër rrafsh më të gjerë, në atë të letërsisë bashkëkohore shqipe.


Profesioni i gazetarit, ashtu siç na ka mësuar eksperiencia e letërsisë boterore dhe asaj shqiptare ka qenë edhe asi nën mëngë i këtij autori, për t'u shfaqur në konturet artit të të rrefyerit, krejt i veçantë dhe me një sfond estetik lehtësisht të dallueshëm. Zoti Meko i dashuron personazhet e tij. Si një piktor që është duke realizuar portrete, ai distancohet nga ata dhe i sheh disi në largësi, duke u vënë emrat që i meritojnë, karakteret që ata përfaqësojnë dhe historinë në të cilën vërtitet jeta e tyre. Ka respekt për personazhet, pasi është duke

